# Hulumtim mbi vendet e lira të punës 2014

**KOLEGJI UNIVERSUM**
Studentet: Edonita Bytyqi dhe Mirdona Sahiti

Ky hulumtim është përkrahur nga Zyra e Karrierës

# Hyrje

Hulumtimi mbi vendet e lira të punës, është një hulumtim i studentëve të Kolegjit Universum, respektivisht Zyrës për Shërbime të Karrierës, i cili ka për qëllim matjen e trendeve, dinamikës dhe structurës së tregut të punësimit në Kosovë.

Kjo analizë do të ju mundësojë studentëve të Kolegjit Universum dhe gjithë punë kërkuesve të kenë informata lidhur me tregun e punës në Kosovë dhe të planifikojnë më mirë karrierën e tyre profesionale.

Zyra për Shërbime të Karrierës e Kolegjit Universum do të vazhdojë të hulumtojë tregun e punës dhe të ofrojë informata të rëndësishme për të interesuarit në këtë fushë.

## Përmbledhja ekzekutive

Hulumtimi mbi vendet e lira të punës bazohet nga statistikat e 4905 konkurseve të shpallura nga burime të ndryshme si: gazetat ditore, portalet elektronike dhe web site të kompanive që kanë ofruar mundësi punësimi. Ky hulumtim përfshinë shpalljet për punë në vitin 2014.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të ofrojë informata relevante rreth ofertës për punë në Kosovë dhe në të njëjtën kohë të identifikojë aftësitë të cilat punëdhënësit kërkojnë tek kandidatët potencial. Poashtu ky hulumtim ka identifikuar sektorët më të kërkuar për vitin 2014 si dhe dokumentet e nevojshme për aplikim.

Konkretisht, ky hulumtim ofron matje të:

1. Pozitat që kërkohen në tregun e punës
2. Sa ka vende të lira puna në Komunat e Kosovës
3. Sektori publik vs Sektori privat
4. Koha kur ka më së shumti vende të lira të punës
5. Kohëzgjatje e kontratës
6. Përgaditja profesionale – Arsimimi
7. Aftësitë e kërkuara
8. Njohuritë e gjuhëve të huaja
9. Përvoja e punës
10. Dokumentet për aplikim
11. Mosha

## Pozitat që kërkohen në tregun e punës

Rezultatet e hulumtimit që kemi bërë janë paraqitur grafikisht për pozitat që kërkohen më së shumti në tregun e punës për vitin 2014 dhe ato që I prijnë kësaj liste janë: Edukim/Trajnim 24% (1195), IT 16%, (797), Shitje 13%(628) , ndërsa sektoret me më së paku vende të lira janë : Sport/Fitness, Rekrutim/Reklamim, Automobilistik/aviacion/Transport, me nga 0% . Pjesa tjetër e % u takon sektorëve të tjera.

**Pozita ofrohet ne sektorin**




| | | |
|---|---|---|
| Administrate | **310** | 6% |
| Arkitekture | **44** | 1% |
| Arte kreative/media | **41** | 1% |
| Automobilistik/aviacion/Transport | **3** | 0% |
| Bukuri/Mode/Dizajn | **45** | 1% |
| Edukim/Trajnim | **1195** | 24% |
| Banka/Financa/Kontabilitet | **140** | 3% |
| IT | **797** | 16% |
| Ligjore/Juridike | **81** | 2% |
| Keshillim | **30** | 1% |
| Sport/Fitness | **0** | 0% |
| Marketing | **80** | 2% |
| Menaxhment | **233** | 5% |
| Siguri/Polici | **180** | 4% |
| Rekrutim/Reklamim | **5** | 0% |
| Shitje | **628** | 13% |
| Telekomunikacion | **23** | 0% |
| Logjistike | **208** | 4% |
| Industri/Prodhimtari | **181** | 4% |
| Turizem/Hoteleri | **214** | 4% |
| Mjekesi/Farmaci | **148** | 3% |
| Infrastrukture/Ndertim | **61** | 1% |
| Inxhinieri | **43** | 1% |
| Mirembajtjes | **184** | 4% |
| Tjeter | **31** | 1% |

## Sa ka vende të lira të punës në komunat e Kosovës

Komuna e cila ka % më të madhe sa i përket vendeve të lira të punës gjatë vitit 2014 është Prishtina duke pasur parasysh se është Kryeqytet i Kosovës dhe ka 2081 vende të lira rrespektivisht 49%.

Pas Prishtinës me vende me të lira të punës është Gjilani,Prizreni dhe Malisheva kurse komunat që kanë më së paku vende të lira pune janë:Leposavici, Zubin Potoku, Zveçani etj.




| | | |
|---|---|---|
| Decan | 14 | 0% |
| Gjakove | 233 | 5% |
| Gllogoc | 62 | 1% |
| Gjilan | 313 | 6% |
| Dragash | 19 | 0% |
| Istog | 53 | 1% |
| Kacanik | 0 | 0% |
| Kline | 72 | 1% |
| Fushe Kosove | 77 | 2% |
| Kamenice | 50 | 1% |
| Mitrovice | 251 | 5% |
| Leposavic | 0 | 0% |
| Lipjan | 30 | 1% |
| Novoberd | 13 | 0% |
| Obilic | 67 | 1% |
| Rahovec | 83 | 2% |
| Peje | 230 | 5% |
| Podujeve | 222 | 5% |
| Prizren | 299 | 6% |
| Skenderaj | 36 | 1% |
| Shtime | 12 | 0% |
| Shterpc | 11 | 0% |
| Suhareke | 22 | 0% |
| Ferizaj | 222 | 5% |
| Viti | 48 | 1% |
| Vushtri | 70 | 1% |
| Zubin Potok | 0 | 0% |
| Zvecan | 0 | 0% |
| Malisheve | 281 | 6% |
| Hani i Elezit | 29 | 1% |
| Mamushe | 1 | 0% |
| Junik | 0 | 0% |
| Kllokot | 0 | 0% |
| Gracanice | 3 | 0% |
| Ranillug | 0 | 0% |
| Partesh | 1 | 0% |
| Prishtine | 2081 | 42% |

## Sektori Publik Vs Sektori Privat

Nëpërmjet këtij hulumtimi kemi rezultuar se sektori publik nuk është sektori I cili ofron më së shumti vende të lira të punës , ashtu siq kemi pritur , por ai privat I cili ka kapur shifrën prej 2998 (61%) vendeve të lira të ofruara duke lënë sektorin publik pothuajse me gjysmë vende më pak të lira pra 1718(35%).

Kurse % tjeter e përbëjnë Organizatat joqeveritare vendore dhe ato ndërkombëtare.

**Institucioni :**




| | | |
|---|---|---|
| Publik | **1718** | 35% |
| Privat | **2998** | 61% |
| Organizate joqeveritare vendore | **19** | 0% |
| Organizate joqeveritare nderkombetare | **170** | 3% |

## Muajt në të cilët ka më së shumti vende të lira të punës

Në grafikun në vijim shohim se mujat me më së shumti vende të lira të punës jane Korriku me 28%(1370), dhe Gushti me 19% (950) .




| | | |
|---|---|---|
| Janar | 39 | 1% |
| Shkurt | 425 | 9% |
| Mars | 341 | 7% |
| Prill | 321 | 7% |
| Maj | 180 | 4% |
| Qershor | 279 | 6% |
| Korrik | 1370 | 28% |
| Gusht | 950 | 19% |
| Shtator | 401 | 8% |
| Tetor | 200 | 4% |
| Nentor | 206 | 4% |
| Dhjetor | 193 | 4% |

## Kohëzgjatja e Kontratave

Në shumicen e rasteve dëshirojme të kemi një punë afatgjate prandaj kontratat afatgjate na japin nivelin e sigurisë në punë, përkundër kontratave tjera, kështu përmes këtij hulumtimi kemi bërë nje relacion ndërmjet kontratave dhe kemi rezultuar se kontratat afatgjate janë ato të cilat prijnë ne grafikun e paraqitur më poshtë me 65% (3168), pastaj ato Afatshkurtër me 9%(450), dhe Kontratë shërbimi me 4% (173) kurse në 23% e vendeve të lira të punës kontrata nuk specifikohet.




| | | |
|---|---|---|
| Afatgjatë | **3168** | 65% |
| Afat shkurter /Internship | **450** | 9% |
| Kontrate sherbimi | **173** | 4% |
| Nuk specifikohet | **1113** | 23% |

## Përgatitja Profesionale/Nivelet e Arsimit

Është më se e ditur se përgatitja profesionale është mjaft e nevojshme për vendet e punës e sidomos në vitet fundit, këtë na bën të ditur edhe ky hulumtim. Në grafikun e mëposhtem e shohim se në 70% të vendeve të lira të punës është kërkuar niveli Bachelor,në 19% Shkolla e mesme, 11% Master jo I domosdoshem,  60% Master kurse në 12% të tyre nuk specifikohet niveli I arsimit.




| | | |
|---|---|---|
| Shkolla e mesme | **918** | 19% |
| Bachelor | **3453** | 70% |
| Master | **60** | 1% |
| Master jo i domosdoshëm | **560** | 11% |
| Nuk specifikohet | **574** | 12% |

## Aftësite e kërkuara

Në grafikun e paraqitur mund të shohim se Aftësia për komunikim tek punëdhënësit është e domosdoshme në 73% të vendeve të lira të punës, në 63% të tyre kërkohet aftësia për punën në grupe, si dhe 44% Aftësi Kompjuterike, kurse aftësite më së paku të kërkuara në vendet e lira të punës janë Mendimi Kritik dhe integriteti në vetëm 1%

**Aftesite e kerkuara ne konkurs:**




| | | |
|---|---|---|
| Aftesi komunikimi | **3595** | 73% |
| Pune ekipore | **3077** | 63% |
| Aftesi intelektuale | **1022** | 21% |
| Aftesi planifikuese dhe organizative | **937** | 19% |
| Vetebesim | **259** | 5% |
| Aftesi kalkuluese | **326** | 7% |
| Personalitet | **1513** | 31% |
| Integritet | **55** | 1% |
| Aftesi ne te shkruar | **137** | 3% |
| Mendimi kritik | **27** | 1% |
| Analize dhe vendimarrje | **380** | 8% |
| Aftesi Kompjuterike (MS Office etj) | **2146** | 44% |
| Patente Shofer | **458** | 9% |

## Njohuritë e gjuhëve të huaja

Siç e shohim në grafikun e dhënë gjuha e cila më së shumti kërkohet për vendet e lira të punës është gjuha angleze me 38% , të pasuara me gjuhën Gjermane dhe Serbokroate në 3% te vendeve të lira.

**Njohuritë e gjuhëve të huaja :**




| | | |
|---|---|---|
| Angleze | **1887** | 38% |
| Serbokroate | **140** | 3% |
| Gjermane | **144** | 3% |
| Italiane | **23** | 0% |
| Turke | **27** | 1% |
| Frenge | **17** | 0% |
| Tjeter | **2116** | 43% |

## Përvoja e punës

Një element tjetër me rëndësi e cila kërkohet nga punëdhënesit është edhe përvoja e punës, gjë të cilen na e vërteton edhe hulumtimi pasi që në 66% te vendeve të lira të punës është kerkuar përvoja e punës.

**A nevojitet përvojë pune :**




| | | |
|---|---|---|
| PO | **3235** | 66% |
| JO | **561** | 11% |
| Nuk specifikohet | **1109** | 23% |

## Dokumentacioni i domosdoshëm për aplikim

Cv-ja dhe dëshmitë mbi shkollimin mbeten si dokumentet më të kërkuara gjatë procesit të aplikimit gjë e cila njëherit na tregon se shkrimit të Cv-së duhet ti kushtohet shumë rëndësi.

**Dokumentet e domosdoshme për aplikim :**




| | | |
|---|---|---|
| CV | **4243** | 87% |
| Diploma | **2050** | 42% |
| Certifikata e lindjes | **1157** | 24% |
| Kopja e letërnjoftimit | **410** | 8% |
| Certifikata e vendbanimit | **756** | 15% |
| Dëshmi mbi përvojën e punës | **1169** | 24% |
| Referenca | **263** | 5% |
| Leter Motivimi | **307** | 6% |

## Mosha e përshtatshme për aplikim

Mosha e përshtatsme për aplikim në shumicën e rasteve nuk specifikohet pra në 89% të tyre. Mosha në vendet  e lira të punës është kushtëzuar në vetëm 11% të tyre, ku në 6% të saj është e preferuar mosha e re 18-25, kurse 5% përfshin moshen  25-35% dhe shumë pak moshën mbi 35.

**Mosha e përshtatshme për aplikim :**




| | | |
|---|---|---|
| nuk specifikohet | **4361** | 89% |
| 18-25 | **307** | 6% |
| 25-35 | **225** | 5% |
| mbi 35 | **12** | 0% |

| 2013 | 2014 |
| --- | --- |
| Pozitat: Siguri/Polici (22%), Edukim/Trajnim(19%), Shitje(13%). | Pozitat: Edukim/Trajnim 24%, IT 16%, Shitje 13% |
| Komunat:Prishtina (49%) Prizren (6%), Podujeva(6%) | Komunat:Prishtina (42%), Gjilani(6%), Prizreni (6%) |
| Sektori Privat (61%), Sektori Publik (37%) | Sektori Privat (61%), Sektori Publik (35%) |
| Muajt: Qershori (22%), Janari (18%) | Muajt: jane Korriku me 28%, dhe Gushti me 19% |
| Kontratat: Afatgjate (62%),afatshkurta(12%) | Kontratat: Afatgjate (65%), Afatshkurta(9%) |
| Arsimimi: Shkolla e mesem(64%), Bachelor(53%) | Arsimimi: Shkolla e mesem(19%),Bachelor (70%) |
| Aftesit:Komunikimi (87%),Punë ekipore (69%) | Aftesit: Komunikimi (73%), Punë ekipore (63%) |
| Gjuhët:Angleze (75%),Serbokroate (11%) | Gjuhët: Angleze (38%), Serbokroate (3%) |
| Përvoja e punës:Po (77%),Jo(0%) | Përvoja e punës: Po (66%), Jo(11%) |
| Dokumentet:CV (86%), Diploma (54%) | Dokumentet: CV (87%), Diploma (42%) |